



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 417/10 prot.

Elbasan, më 23.02/2024

**VENDIM**

Nr. 16, datë 23.02.2024

**Për mbylljen e programit të studimit Bachelor në "Histori dhe gjuhë gjermane"**

Në mbështetje të Ligjit 80/2015, datë 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 35, pika 1, neni 38, pika 1 germa "dh" të Udhëzimit të MASNr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar Kreu IV, germa C, pika b,c,d në shkresën me Nr. 36, datë 09.02.2024 të Fakultetit të Shkencave Humane, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 23.02.2024

**VENDOSI:**

1. Të mbyllet në Fakultetin e Shkencave Humane programi i studimit Bachelor në "Histori dhe gjuhë gjermane".
2. Studentët e ngelur të këtij programi studimi ti krijohet mundësia e shlyerjes së provimeve ose ti transferojnë ato në një program të ngjashëm.
3. Ky vendim ti dergohet MAS dhe Bordit të Administrimit për procedura të metejshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Prof.Dr.Skender TOPI**

